



UNMIK

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE

Në përputhje me nenin 11.1 si dhe nenin 14 të Ligjit 2003/23 Për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë, me qëllim të funksionimit efikas dhe të drejtë të strukturave organizative të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. **Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerrë këtë:**

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR 13/2004
PËR
ADMINISTRIMIN E PAGESAVE TË SKEMËS SË PENSIONEVE PËR PERSONAT
ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Neni 1

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ

1.1 Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim rregullimin e procedurave përkitazi me mënyrën e administrimit të pagesave të skemës së pensioneve për personat me aftësi të kufizuara.

Neni 2

Administrimi me pagesat e pensionit të aftësisë së kufizuar

2.1 Administrimin e pagesës së pensioneve të aftësisë së kufizuar (PAK), në bazë të autorizimit të MPMS-së e bënë Administrata Pensionale e Kosovës.

2.2 APK-ja, këtë administrim e bënë përmes qendrës dhe zyrave rajonale të Administratës pensionale të Kosovës.

2.3 Pagesa e PAK-së iu paguhet vetem personave që i plotësojnë kushtet dhe kriteret sipas ligjit.

2.4 Persona që i plotësojnë kushtet për pagesë, konsiderohen ata të cilët, Komisioni mjekësor i vlerëson si persona më aftësi të kufizuara dhe për çdo rast konkret egziston vendimi pozitiv i DAPK-së.

- 2.5** Pagesa e PAK-së është e përmuajshme dhe shuma është e njëjtë me pensionin themelor.
- 2.6** Pagesa e këtij pensioni mund të bëhet edhe në mënyrë prapavepruse (retroaktive).
Për këtë vendos Ministria me një urdhëresë të vacantë duke caktuar edhe periudhën kohore të një veprimi të tillë.
- 2.7** Pagesa e PAK-së bëhet përmes llogarive bankare të përfituesve.
- 2.8** Llogaritë bankare hapen nga nënpunësit APK-së me pëlqimin e përfituesve .
- 2.9** Rezultatet e komisionit mjekësor futën në bazën e shënimeve, dhe procedohen më tutje.

Neni 3

Autorizimi i Pagesës

- 3.1** Autorizimin e pagesës e bënë nënpunësi i pensioneve i sektorit të pagesave në bazë të shënimeve të sistemit të TI-së për PPAK-në.
- 3.2** Përmes sistemit të TI-së bëhet llogaritja e shumës për pagesë të pensionit për çdo muaj sipas shumës së caktuar për PPAK-në.
- 3.3** Nënpunësi i Pensioneve për pagesë lëshon vendimin për njoftimin mbi pagesën, me të cilin bëhet konfirmimi i dhënies së pensionit, shumës së pagesës, shumat e papaguara (nëse ka), vendimin e pagesës dhe datën e pagesës.
- 3.4** Nënpunësi i pensionit ia dërgon një kopje të vendimit (njoftim mbi pagesën) përfituesit të pensionit.
- 3.5.** Nënpunësi i pensioneve e vendos një kopje të vendimit (njoftim mbi pagesat) në dosje të përfituesit

Neni 4

Procesimi dhe kalkulimi i pagesave

- 4.1.** Nënpunësi i pensioneve i ngarkuar për përgatitjen dhe caktimin e listës së pagesave nxjerr, raportin e listave të pagesave për pagesa nga baza e shënimeve.
- 4.2** Në sistemin e TI-së ruhet versioni elektronik i pagesave të përfituesve si dhe raportet e përgjithshme dhe raportet e ndara sipas bankave.
- 4.3** Lista e pagesave të secilit përfitues përfshin këto informata:
a. Emrin dhe mbiemrin e përfituesit

- b. Nr.e letërnjoftimit të përfituesit
- c. Shumën e pagesës
- ç. Shërbimin e pagesës-Degën- (Filialin)
- d. Nr.e llogarisë së pagesës

- 4.4** Nënpunësi i pensioneve do të nënshkruajë listat e pagesës dhe tërë dosjen ia dorëzon menaxherit për kontroll dhe autorizim final.
- 4.5** Menaxheri i pagesave verifikon listën e pagesave (dhe sigurohet se dosja ka dokumentacionin e duhur për pagesë) dhe e nënshkruan listën e pagesës.
- 4.6** Menaxheri i sektorit të pagesave autorizon dërgimin e dosjeve për shënimet e pagesave në banka.
- 4.7** Nënpunësi i pensioneve sipas autorizimeve të menaxherit të pagesave i dërgon dosjet përfundimtare të dhëna për pagesë në secilën bankë në pajtim me memorandumun në mes të MPMS-së dhe bankave.

Neni 5

Pagesa

- 5.1** Menaxheri i pagesave e dërgon listën e pagesave në sektorin e financave që të bëjë përgatitjen e CPO-së dhe kërkesën për transfer bankar (për BPK-në).
- 5.2** Menaxheri i financave e dërgon CPO-në dhe kërkesat për transfer bankar në menaxhmentin e DMS-së (DAPK-së) MEF-it dhe BPK-së.
- 5.3** Nga momenti i transferit të mjeteve në bankë, përfundon procedura fillestare e skemës së pagesave për pensionet e personave me aftësi të kufizuara.

Neni 6

- 6.1** Ky Udhëzim Administrativ, do të hyjë në fuqi, ditën e nënshkrimit nga Ministri i MPMS-së, ndërsa do të implementohet nga momenti kur fillon paraqitja e pagesave për pensionin e aftësisë së kufizuar.

Ministri i MPMS-së
Ahmet Isufi

Prishtinë, Maj 2004

Ndërtesa e re e Fakultetit Ekonomik
Prishtinë,

Neë building of economic faculty
Prishtina
Tel. 038/244 228, Fax.038/244 229

Zgrada novog ekonomskog fakulteta
Priština